



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË  
KOMISIONI ZHVILLIMIT TË KARRIERËS

OPINION

**Mbi transferimin e përkohshëm të znj. Dorina Bejko në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)**

**KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË**

Me shkresën nr. 2143/2 prot. dt. 17.03.2021 të Prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (SPAK) me objekt “Mbi caktimin e përkohshëm të një prokurori”, kjo prokurori i kërkon Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të japë mendim në lidhje me transferimin e përkohshëm të znj. Dorina Bejko e cila ushtron funksionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec (caktuar përkohësisht).

Në shkresën e sipërcituar, nga ana e Drejtuesit të kësaj prokurorie theksohet fillimisht fakti që nga 15 prokurorë që ka aktualisht në strukturë kjo prokurori, detyrën efektivisht e ushtrojnë vetëm 13 prokurorë. Gjithashtu Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka miratuar për vitin 2021 një numër prej 20 prokurorësh, procedurë kjo që nuk është filluar akoma nga ana e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Theksi nga ana e Drejtuesit, vihet gjithashtu edhe tek ngarkesa shumë e madhe që ka aktualisht kjo prokurori.

Në përmbushje të përcaktimeve të pikës 3 të nenit 46 “transferimi i përkohshëm” ku përcaktohet se :

*“Për çështje voluminoze dhe komplekse, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund t’i kërkojë kryetarit të prokurorisë së shkallës së parë të japë pëlqimin për transferimin e prokurorëve me kualifikim të veçantë në zyrën e Prokurorisë së Posaçme, për të punuar me çështje të veçanta, për një periudhë të caktuar.”*

Drejtuesi i Prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar i është drejtuar me shkresën nr.2143 prot. të datës 09.03.2021 Drejtuesit të prokurorisë, pra vetë znj. Bejko të japë pëlqim për këtë transferim.

Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec (që është njëkohësisht edhe prokurori që do të transferohet njëkohësisht) me shkresën nr. 1168/1 prot. të datës 12.03.2021, ka dhënë pëlqimin për këtë transferim si dhe ka argumentuar njëkohësisht se fakti që për momentin

organika e kësaj prokurorië është e plotësuar edhe me 3 prokurorë të tjerë, nuk pas sjell pengesa serioze në veprimtarinë hetimore dhe administrative të saj.

Referuar pikës 4 të nenit 46 “transferimi i përkohshëm” ku përcaktohet se :

*“Para se të merret vendimi për transferimin, sipas pikës 3, të këtij neni, Kryetari i Prokurorisë së Posaçme kërkon mendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për transferimin dhe kualifikimin e prokurorit përkatës. Këshilli i Lartë i Prokurorisë mund të japë mendim jo të detyrueshëm të paktën tre ditë pas marrjes së kërkesës.”*

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, duhet të japë një opinion në lidhje me transferimin e përkohshëm të prokurorëve nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithëm në atë të posaçëm, ndërkohë që vendimi i transferimit merret nga vetë Drejtuesi i Prokurorisë së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

*Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, duke vlerësuar të gjithë faktorët e sipërpërmendur si dhe faktin që znj. Bejko ka kualifikimin e duhur dhe plotëson kushtet për ushtrimin e kësaj detyre, mendon se transferimi i përkohshëm i saj nuk cënon punën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec, duke ndihmuar në uljen e ngarkesës në Prokurorinë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Vlen të theksohet fakti se Prokuroria e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar për shka të natyrës së veprimtarisë së saj si dhe të ndjeshmërisë që ka në opinionin publik, përbën një prioritet të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.*

**Sa më sipër, Komisioni, vendosi t’i propozojë Këshillit, dhënien e një opinionit pozitiv për transferimin e përkohshëm të prokurores Dorina Bejko në Prokurorinë e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.**

**Ne menyre qe KLP te bej te mundur zevendesimin e Drejtuesit te Prokurorisë prane Gjykares se Shkalles se Pare Pogradec, i sygjerojme drejtuesit te SPAK qe urdheri i transferimit te behet efektiv jo me heret se dy jave nga data e miratimit te ketij opinionit ne keshill.**